



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**BASHKIA MALIQ**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Datë 26.12.2023

Prot.14 (katërmëbëdhjetë)

Protokoll nr. 14

I mbajtur sot më datë 26.12.2023, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend dite:

- 1.Hapja e mbledhjes (korumi,miratimi i rendit të ditës,vendimet e mbledhjes së kaluar);
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.11.2023;
- 3.P-V “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2024”;
- 4.P-V “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe struktura të tjera për vitin 2024”;
- 5.P-V “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024”;
- 6.P-V“Për miratimin e listës të investimeve prioritare të Bashkisë Maliq për vitin 2024”;
- 7.P-V “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026”;
- 8.P-V “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”;
- 9.P-V “Për miratimin e shpérblimeve honorare për artistët amatorë”;
10. P-V “Për miratim bursa për nxënësit ekselentë”;
- 11.P-V “Për shpérblim valltarë”;
- 12.P-V “Për miratimin e raportit të likujdimit të shoqërisë “Klubi i Futbollit Maliq” sh.a.
- 13.P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin nëntor 2023”;
- 14.P-V “Për miratimin e bursave të arsimit së mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të mesëm profesional të vitit shkollor 2023-2024”;
15. Diskutime të tjera.

**Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi; Eriseld Jonusllari;Pranvera Begolli;Gentiana Drabo; Dritan Çami; Aramando Dautllari; Marianthi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Avrami; Danjela Ibrahim; Plator Çollaku; Klea Baçi; Rovena Terolli; Andonaq Risto; Aleksandra Spaho; Idlir Limllari; Dalina Krekas; Ilia Xhuti 20 (njëzetë) këshilltarë.

**Të pranishëm nga Administrata:** Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu;Drejtore e Financës dhe Nën/Kryetar i Bashkisë:Eridion Rustemi; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:Ermandë Petriti; Drejtore e Drejorisë së të Ardhurave; Jona Grabocka; Drejtore e Drejorisë e Planifikimit të Territorit:Enkelejda Jonusllari;

Buxhetit:Almira Muka; Drejtor i Burimeve Njerzore dhe Prokurimve:Genci Floqi; Drejtore e Drejorisë të Ardhurave:Jona Grabocka; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social dhe Strehimit:Ermandë Petriti

**Ornildi Demollari:**Mirëdita të gjithve!Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetar I Bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë Maliq, mbledhja më e rëndësishme e vitit, pasi në këtë mbledhje miratohet dhe buxheti për vitin e ardhshëm dhe shpresojmë që të jetë një buxhet sa më pranë nevojave dhe kërkesave të qyterave.Verifikojmë si fillim korumin, duke bërë aplelin.Këshilltarët që nuk janë të pranishëm:Xhuana Hoxhallari; Enida Avdolli;Fevri Sherifi; Almir Elezi; Yllson Ibrahimllari; Nersida Shindo; Server Xhuti;Albina Xhejo; Eglantina Balli; Faslli Zholl;Lulëzim Hoxhaj, korumi realizohet jemi 19-20 Këshilltarë në sallë dhe mund të vazhdojmë me rendin e ditës.Miratojmë rendin e ditës? I cili përbëhet nga 15 pika.

Kush është dakord me rendin e ditës ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës? Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.11.2023;Në këtë proceverabl janë pesë vendime me karketer normativ kanë shkuar për verifikim pranë Institucionit të Prefektit dhe kanë marrë dakortësinë dhe pesë të tjera me karketer individual ose kolektiv të cilat nuk kanë nevojë të shkojnë në Prefekturë. E miratojmë procesverbalin?

Kush është dakord me procesverbalin ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit!

**Ornildi Demollari:**Shkojmë te pika e tretë e rendit të ditës, P-V “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2024”; Ka ndonjë pyetje? Komisioni i Financës?

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Përrshëndetje të gjithve! Të nderuar Këshilltarë, të nderuar qytetarë, kjo është mbledhja më e rëndësishme e bashkisë tonë, vijmë sot me një bilanc pozitiv, vijmë sot me një buxhet që është më i lartë se një vit më parë, kjo fal punës tonë, por dhe mbështesë së qeverisë Shqipëtare për të rritur transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën specifike, për funksionet që ne mbulojmë sipas ligjit organik.Po bëj një hyrje të buxhetit të këtij



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

viti dhe patjetër do hy dhe te paketa fiskale.Buxheti i bashkisë këtë vit kap një vlerë prej 91 0.097 lekë, buxheti është i blancuar pa deficít, pavarisht të dy projekteve 3-vjeçare të cilat ne tashmë i kemi futur në punë.Në totalin e përgjithshëm ne do të shpenzojmë fond për paga dhe sigurime shoqërore në një vlerë prej 451.631 lekë, shpenzime opreative 176.746 lekë dhe investime 241.756 lekë, keni tabelë, relacionin shpjegues për atë që ne kemi menduar.Do realzjojmë dy objekte të shtrira në kohë, I është objekte ndërtimore rrëth 25 milon lekë, e cila do ndërhyjmë në disa banesa kolektive, për reabilitim të çative që ti paraprijmë investimit të madh të FSHZH, për veshjen me kapot të pllateve në Maliq, Drithas ku situata është më e vështirë, këtu kemi futur dhe investime në rrugë, sistemim-asfaltim në një vlerë prej 75 milon lekë.Në lidhje me kuotat e tjera kap një vlerë 39.966 lekë sipas zërave, më poshtë keni dhe tabelën të investimeve.Në lidhje me paketën fiskale jemi në të njëjat nivle si një vit më parë, kemi një buxhet të pavaruar rrëth 300 milon lekë, të cilat nuk kanë ndryshim të madh, kemi bërë disa rregullime të tarifave që ka sjellë Shërbimi Pyjor, apo Drejtoria e Planifikimit të Territorit, përfketët të lejave të ndërtimit, ka një rritje të tarifës të pastrimit me 300 lekë, duke marë punën që bëhet në territorin e bashkisë dhe kërkosat e qytetarve për të shtuar kontenierë dhe sipërfaqet e pastruara kemi bërë këtë shtesë minimale.Në nivelin e përgjithshëm nuk ka një rritje të paketës fiskale, nga informacioni dhe tabelat që ju keni, është e detajuar.Atë që dua nënvizoja janë përjashtimet nga kjo paketë:

**Përjashtime:**

- Për bizneset e reja, të cilat administrohen nga gratë kryefamiljare, tarifat vendore reduktohen në masën 30% për vitin e pare të ushtrimit të aktivitetit.
- Familjet që trajtohen në ndihmë ekonomike, ose që përbëhen nga “*pensionistë të vetmuar*” , do të paguajnë vetëm 70% të tarifave.
  - Në kategorinë “*pensionistë të vetmuar*” përfshihen të gjithë pensionistët e vetëm, pa përkrahje, që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Lista me të dhënat për këta persona do të sigurohet nga Sektori i Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Maliq.
- Gratë kryefamiljare që nuk janë në marrëdhënie pune përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.
- Të përjashtohen nga tarifa e gjelbërimi familjet e fshatrave:
  - Në Njësinë Administrative Gorë të gjitha fshtarat.
  - Në Njësinë Administrative Moglicë të gjitha fshtarat.
  - Në Njësinë Administrative Libonik, fshatrat Zboq, Beras, Shkozë, Kembëthekër, Mëmël dhe Manastirec.
  - Njësinë Administrative Pirg fshatrat Bubuq dhe Qershizë.
- Të përjashtohen nga tarifa e pastrimit të gjithë banorët e fshatrave:
  - Në Njësinë Administrative Gorë të gjithë banorët e fshatrave përvç : Zvarisht, Lozhan i ri dhe Lozhan.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

- Në Njësinë Administrative Libonik, banorët e fshatrave Zboq, Beras, Shkozë, Kembëthekër, Mëmël dhe Manastirec.
- Në Njësinë Administrative Maliq, banorët e fshatrave: Bickë, Goçë, Plovisht dhe Gjyras.
- Në Njësinë Administrative Pirg, banorët e fshatrave: Bubuq dhe Qershizë.
- Në Njësinë Administrative Moglicë të gjithë banorët e fshatrave përveç fshatit Moglicë.
- Të përjashtohen nga tarifa e ndriçimit:
  - Në Njësinë Administrative Maliq, banorët e fshatrave: Bickë, Goçë, Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Adminstrative Libonik, banorët e fshatrave: Shkozë, Këmbëthekër, Beras, Zboq, Memël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Adminstrative Gorë, banorët e fshtarave : Shalës, Selcë, Marjan, Dolanec, Mjaltas, Babjen.
  - Në Njësinë Admnistrative Moglicë përveç Moglicës, Zerecit dhe Popçisht të gjithe fshatrat e tjerë përjashtohen nga tarifa e ndriçimit.
  - Në Njësinë Administrative Pirg banorët e fshatit Bubuq dhe Qershizë.
- Të përjashtohen nga tarifa për mirëmbajtjen e varrezave publike:
  - Në Njësinë Administrative Maliq, banorët e fshatrave: Bickë, Goçë, Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Adminstrative Libonik, banorët e fshatrave: Shkozë, Këmbëthekër, Beras, Memël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Administrative Pirg banorët e fshatit Bubuq dhe Qershizë.
  - Në Njësinë Adminstrative Moglicë, banorët e fshtarave : Dobercan, Nikollare, Vrepcke, Torrovec, Varvare, Osoje, Protopape, Gopesh, Rosover, Kucake.

*Shënim: Përjashtimi nga tarifa e mirëmbajtjes së varrezave nuk zbatohet në asnjë rast kur pas hyrjes në fuqi të Paketës Fiskale, do të kryhen investime në varrezat e fshatrave të mësipërm respektivë.*

- Të përjashtohen nga tarifa e mirëmbajtjes së kanaleve kullues:
  - Në Njësinë Administrative Maliq, banorët e fshatrave: Bickë, Goçë, Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Adminstrative Libonik, banorët e fshatrave: Shkozë, Këmbëthekër, Beras, Zboq, Memël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Administrative Pirg banorët e fshatit Bubuq dhe Qershizë.
  - Të gjithë banorët e Njësive Administrative Gorë dhe Moglicë.
- Familja që klasifikohet në kategorinë emigrant përjashtohet nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelberimit.
  - Në këtë kategori përfshihen ato familje që disponojnë dokumentin e mëposhtëm :



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

- Pasaportë me vulat që vërteton hyrje - daljet nga territori i vendit, me kohë qëndrimi mbi 6-muaj.
- Përjashtohen nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelberimit familjet të cilat kanë lejë e banimit në territorin e Bashkisë Maliq por që jetojnë jashtë këtij territori, këto familje duhet të disponojnë një vërtetim banimi nga administratori i lagjes ku jetojnë.
- Te aplikohet ulje 10 % e tarifave vendore për të gjithë familjarët apo cdo subjekt debitor i cili i shlyen të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifat vendore të prapambetura me një këst të vetëm.
- Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.
- Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:
  - a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime joftimprurëse;
  - b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
  - c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
  - d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
  - e) pasuritë e paluajtshme - ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
  - f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
  - g) strukturat akomoduese “ *Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special* ”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “ *brand name* ”;
  - h) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përsitojnë pension pleqërie/ pension social/ kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa astë për punë;
  - i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
  - j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përherershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime joftimprurëse.
- Përjashtime nga Taksa e Tokës

Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore, tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për 5 vitet e para nga çasti i mbjelljes. Drejtoria e Bujqësisë në Bashki të përcaktojë mbjelljet e çdo vitit kalendarik. Për çdo fermer që rezulton se ka mbjellë kultura drufrutore ose vreshtari në 5 vitet e fundit pajiset me një dokument të lëshuar nga agronomi i Njesise Administrative dhe Administratori respektiv.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Dua të bëj një sqarim që pastrimi në Gorë dhe Moglicë bëhet nga punëtorët dhe mjetet e bashkisë, këto janë disa përjashtime të cilat kërkojnë konfirmimin tuaj para se të hyjmë në pjesën e buxhetit. Shumë faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit Kryetar! Kemi ndonjë pyetje? Po.

**Aleksandra Spaho:** Përshtendje! Në mbledhjen Komisionit, kam propozuar të përjashtohen nga të gjithë bizneset që hapen nga të rinj 18-35 vjeç, për një kohë 3-veçare dhe te pensionistët e vetmuar të moj jetë 70% sepse nuk besoj se janë shumë në numur, nëse bëjmë diçka më shumë di ishte më mirë ose ti përjashtojmë totalisht. Ky është propozimi im.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit!

**Petrin Kupe:** Nëse nuk kanë diçka tjetër Këshilltarët? Mund të flas në emër të komisionit të financës.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:** Është e vërtetë që kemi diskutuar këto dy momente, do jem shumë dakord dhe të shpresojmë që të ketë sa më shumë biznese nga të rinjtë, do isha që ne ti përjashtojmë 1-2 vjet nga taksat dhe tarifat vendore bizneset që janë në këtë moshë, ajo që e kam me merak se mund të ndodhë, nuk duhet të përfshihen bizneset aktuale, duhet të jemi korrekt me atë çka do bëjmë, se mund të ndodhi që babi e kalon biznesin te i biri. Duhet të kemi biznes të ri, në godinë, me person të ri, do ti propozoj këshillit ta praktikojmë për një vit buxhetor dhe pastaj shohim, për pensionistët e vetmuar të jetë 50% e tarifës, drejtoria e të ardhurave të na sjelli një informacion sa është numri se jemi në kohë për ti përjashtuar 100% ndoshta, por do isha të shkojmë 50%, pasi drejtoria të na sjellë një informacion në mbledhjen e radhës dhe mbasse e shtojmë në Paketën Fiskale. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! E do dikush fjalën para komisionit?

**Petrin Kupe:** Për sa i përket buxhetit në të tre P-V, Paketë Fiskale, Strukturë, Buxhet ne e trajtuam si Komisioni Finance dhe konkulzionet do ti themi për të treja. Për sa i përket sistemit të taksave nuk ka problem për të diskutuar sepse nuk ndryshime në rritje, me përjashtim të një lloj takse që ne e quajmë të llogjikshme që ajo të rritet, sepse shkojmë që dhe shërbimi i pastrimit është përmirsuar ndjeshëm në gjithë territorin e bashkisë Maliqit, atje ka shumë taksa që janë teorike dhe të paaplikueshme, janë dhe shumë tarifa që janë vetëm të shkruara dhe nuk apikohen, kështu që ato nuk janë objekt diskutimi dhe për këtë pjesë jemi plotësishët dakord të miratohet ashtu si është parqitur. Për sa i përket strukturës ky është një moment i rëndësishëm e cila është kompetencë e kryetarit të bashkisë ta ndërtojë strukturën e tij ashtu si i shërbën më mirë punës së tij dhe komunitetit. Kalojmë te pjesa e buxhetit, është për tu vlersuar rritja e buxhetit 9.1 milardë lekë nga 8.3, 9.6% është rritur transferta e pakushtëzuar, ndërsa ngelet në nivelin 100% parashikimi të ardhurave nga bashkia për vitin 2024, është gjykuar drejt pasi treguesi i mbledhjes së të ardhurave, është një treguesit që nuk është realizuar si duhet nga bashkia. Ky buxhet ka shumë sfida të cilat duhet ti përballojë në vitin 2024 dhe një nga këto përmendin tonë është realizimi i të ardhurave, ashtu si e përmenda dhe më sipër, realizimi i të ardhurave është në nivele jo të kënaqshme, ku kryetari i bashkisë ka bërë një analzi më të hollësishme për çdo NJ.A, për çdo inspektor, mos realizimi i të ardhurave nga bashkia përbën problem pastaj dhe për investimet, kjo është një sfidë që duhet të përballohet për këtë vit, mendojmë se sfida të tjera,



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

duhet të jetë në qendër të punës të bashkisë dhe problemi i pagave, atje ka një fond të destinuar përritjen e pagave, duhet parë momneti kur duhet të bëhet, të shkojë në unision me VKM-në, pagat janë akoma të ulta për ne. Për sa i përket investimeve u përmend dhe nga Kryetari, janë investime që zenë peshë ato të filluara në vitin 2023 të papërfundura, si psh sistemim-asfalitim i shumë rrugve, pasi ato janë kryer në vetëm 70% të punimeve të parashikuara, ajo që më intreson dhe si këshilltar i Libonikut, Drithas-Libonik-Maliq të kthehet në një qendër urbane, spese janë parashikuar, çati dhe veshje pallatesh dhe me realzimin e një kërkese të vazhdueshme që të ndërtohet shëtitorja nga kryqëzimi i Libonikut deri te ura e Dunavecit, e cila do ti shërbej ju vetëm banorve për sgorinë e jetës, sepse kjo rrugë është mjaft e rezikshme për aksidente, kjo di i shërbejë dhe zhvillimit të turizmit dhe në fund mbylljet me një investim deri diku të vonuar me reabilitimin e fushës të sportit të fshatit Drithas. Realizimi i investimeve këtu përmendet, nga të ardhurat dhe buxheti i bashkisë, ne shohim që janë parashikuar fonde dhe për hartimin e projekteve, kjo për të bërë investime dhe nga të ardhurat e veta, por dhe nga buxheti i shtetit dhe nga forma të tjera si shoqata e tij. Këto mendojmë ne ishin disa nga sfidat që duhet të përballohen në buxhetin e vitit 2024 dhe kemi besim që me punën e administratës të bashkisë dhe me punën e kryetarit të bashkisë, këto investime do bëhen të realitet. Faleminderit!

**Ornildi Demollari:** Petrit faleminderit! Do shtosh diçka kryetar?

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:** Mendoj të votohe paketa fiskale, pastaj vazhdojmë.

**Ornildi Demollari:** Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:** Të miratohet me dy ndryshime:

- Për bizneset e reja, të hapur rishtazi, të cilat admnistrohen nga të rinj të moshës 18-25 vjeç, përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore për vitin 2024. (*Për subjekte të reja , me objekt të ndryshëm nga aktiviteti familjar primar.*)
- Familjet që përbëhen vetëm nga “*pensioniste të vëtmuar*” do të paguajnë vetëm 50 % të tarifave.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:** Drejtoria e të Ardhurave në mbledhjen e radhës të na sjellë një informacion sa është numri i të mosurave të vëtmuar.

**Ornildi Demollari:** E kalojmë në votim Paketën me këtu dy ndryshime?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika e 4 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe struktura të tjera për vitin 2024”;



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**E përmemdi pak Petriti si përsaqësues i Komisionit të financave, në fakt me pagat nuk jemi atje ku duhet, nuk kemi bërë ndryshim të madh në materialin që ju keni, presim të dali VKM në fillim të vitit për ndryshimin e pagave për administrat e bashkive, përfketët të njësimit të tyre në nivele kombëtar me gjithë administratën shtetërore, bazuar dhe politikat e qeverisë, por dhe bazuar në ligjin përaktës për pagat, fondi prej 22 milion lekë që na është çelur, përritje pagash gjatë vitit 2024, nga të cilat 20 milion lekë ne i kemi futur si fond të konsoliduar, është përrregullimin e pagave pasi VKM të jetë efektiv, jemi në pritej të saj dhe kjo kërkon një vendimarrje besoj shumë shpjet. Struktura e bashkisë është, 614 punonjës, nga të cilat 421 i paguajmë ne me fondet tona dhe 193 janë funksioni të deleguara që i keni në pasqyrat përkatse, nuk kemi rritje poziconesh, por vetëm rregullim që vetë Këshilli i bashkisë i ka miratuar gjatë vitit 2023, me përashtim të disa bashkimeve që i kemi parë të arsyeshme përti bërë dhe përfketët të përmirësimit të punës, apo dhe përvendosjen e njerzve në pozicionet përkatëse, ajo çka na shetëson ne ka të bëjë me strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave, e cila është një sfidë më vete për realzimin e të ardhurave, nuk jemi në nivelin e duhur kjo përhartimin e buxhetit të pavarur pa rezerva, kjo dhe për shkak të të ardhurave nga drutë e zjarri që e kemi si zë, është një shumë e konsiderueshme, që nuk mblidhet dhe as nuk harxhohet, por si planifikim dhe si detyrim ligjor ne e parashikojmë, kjo praktikë ndiqet dhe nga bashki të tjera. Ne na ka dhënë rezulatat përtatë që realizojmë gjatë vitit buxhetor dhe ulim prokurimet publike, që bëjnë të mundur që të realizojmë sa më shumë punë me më pak lekë, i keni sipas strukturave, nëse keni pyetje? Mund të kemi disa lapsuse për disa pozicione që duhet të rregullohen, përfketët të oreve etj. Kjo nuk përbën problematikë, me Komisionin e Financës kemi diskutuar nuk kemi patur asnjë problematikë, ne jemi ta kalojmë në këto nivele dhe në momentin që do kemi një vendimarrje të KSHM për njësimin e pagave, patjetër do kemi një përimirësim të pagave të Administratës të bashkisë, këtë rritje e kanë marrë punonjësit e shërbimeve, kanë marrë një rritje të konsiderueshme në krahësim me strukturat të cilat kanë marrë një rritje 3000-5000 lekë, është minimale po ta krahësoh me bashkitë e tjera. Duhet ti kërkojmë pononjësve ti hapin më shumë punë vetës, përtatë justifikuar këtë rritje, kjo kërkon një analizë më të thellë nga ne.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Kemi diçka? Po.

**Aleksandra Spaho:**Së pari kam një pyetje? Pasi të miratojmë strukturën, a mund të na vihen në dispozicion emrat përfketët të pozicionit, lejohet me ligj kjo? N.J.A Pirg më duket se ka fryrje të punonjësve dhe disa pozicione që dua të më shpjegohen, mirëmbajtës këtë rritje dhe bojaxhi, nuk e di çfarë këtë rritje ka një përimirësim të pagave të Administratës të bashkisë, këtë rritje e kanë marrë punonjësit e shërbimeve, kanë marrë një rritje të konsiderueshme në krahësim me strukturat të cilat kanë marrë një rritje 3000-5000 lekë, është minimale po ta krahësoh me bashkitë e tjera. Duhet ti kërkojmë pononjësve ti hapin më shumë punë vetës, përtatë justifikuar këtë rritje, kjo kërkon një analizë më të thellë nga ne.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Sa përtatë saktësuar e citoi Petriti në emër të komisionit, kompetenca e këshillit është vetëm të miratojë numrin maksimal të punonjësve dhe pagat e tyre, pastaj Kryetari vendos kufirin e pagave, sepse dhe kufiri ka një nivele maksimal dhe nivel minimal, po të merreshin të gjithë Këshilltarët me 600 punonjës që jo të gjithë i paguajmë ne, ka pozicione që paguhen me fondet e Ministrisë, kështu nuk do dalim dot. Përfketët të konkret që ju



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ

flsini ne kemi një në Pirg, kemi dhe në Shqitas, ai nuk bën vetëm atë punë.Kaldaisti është një punë e rëndësishme, ai punon ato 3 muaj, gjatë vitit bën dhe punë të tjera, çdo njeri ka të drejtë të informohet në bazë të ligjit për informimin publik, përfshi dhe emrat e administratës.Unë, Administratorët, përgjegjsat e Sektorit, kemi për detyrë të vemë në punë punonjësit që ata të janë sa më efektivë, ka punonjës që paguhen me orë të diferencuar.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord me strukturën ? 20 vota pro  
Kundra? Nuk ka  
Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pikë e 4 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq përvitin 2024”;

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Të nderuar Këshilltarë! Ashtu si e thashë dhe më parë, buxheti është një sfidë për çdo institucion edhe për ne si bashki e Maliqit, në kuadër të asaj që ne duam të rruajmë ritmin tonë, duam që në asnjë vit mos ngelemi në gjumë, ndaj edhe ky buxhet në vetëvetë është sfidë për ne, për ne nuk është vetëm të bëjmë 2-3 punë të mëdha, për këtë arsy i hapim sfidë vetes.Buxheti përmban, parime themelore, objektiva, objekte strategjike, ajo çka ne kërkojmë është, të konsolidojmë procedurat e menaxhimit të sistemit financiar, që me më pak lekë të realizojmë punë sa më shumë punë, objektivi i dytë ka të bëjë me zhvillimin e infrastrukturës të mëtejshme edhe pse po ndërhyjmë në shumicën e fshatrave me asfalt, kanalizme, ujësellsa, kjo nuk do të thotë që nuk vazhdojmë punën, ndaj edhe ky projekt ndjek investime të prapambetura por edhe investime të reja të cilat janë objektiva kryesorë në punën tonë.Objektivi strategjik i tretë ka të bëjë me rritjen e kapaciteteve prodhuase të tokave bujëqsore, pasi fusha e Maliqit, është fusha e dytë më e rëndësishme në vend, investimet që ne po realizojmë si në përmirësimin e kanaleve vuditës dhe pastrimi i kanalve vuditës ndër vite që është një punë voluminoze, po bëjmë investime të rëndësishme në përmirësimin e ujëmblethsave si ai i Podgories që eleminon përbashkët, Hidrovori i Vreshtasit, stacioni i pompimit në Pojan, rritja e kapaciteteve ujite në fushën e Maliqit është një sfidë më vete, e cila na ngarkon me detyra konkrete.Ky buxhet përfshin shumë elementë, ka objektiva të tjerë, për arsimin, shëndetësinë, kulturën, për sportin, mbështetje për zonar rurale përfshin përmirësimin e infrastrukturës dhe në këto zona, përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm apo dhe ritja e turizmit, ndërtimi i rrugës Maliq-Lozhan-Moglicë, apo investimet e tjera të mëdha do e kthejnë këtë zonë, në një nga zonat më të bukura dhe më të frekuentura, le të jetë ky një apel për fillimin e ngritjes të Bujtinave të para në këtë zonë.Objektivat përvitin 2024 janë të shumtë, ju si Këshilltarë i keni materialin që ju kemi sjellë bashkangjitur.Ky buxhet do të jetë online në faqen e bashkisë, që do jetë i aksesusshëm nga të gjithë qyetarët, bizneset etj.Ne kemi bërë takime me të gjithë grupet e interesit, me OJQ për të cilat kemi marrë vendime të bëjmë projekte të përbashkta, me Këshillin e Qarkut Korçë po ashtu do kemi investime dhe këtë vit.Rritja e transfertës të pakushtëzuar nga neveria këtë vit ishte shumë pozitive, duke shtuar këtu dhe transferten e pakushtëzuar dhënë nga neveria në fund të vitit përmirësimin e deryrimeve të prapmabetuara na lehëtsoj shumë në buxhet dhe kjo ka një përmirësim po ta shikonit në tabelën përfundimatare.Sektoret



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

sektoriale vazhdojnë ashtu si një vit më parë, kemi personelin mësimor dhe jo mësimor arsimin parashkollar edhe personelin jo mësimor arsimi i mesë, Rrugë Rurale, Ujtje Kullimin, MZSH, Mbrojtja Civile ku kemi parashikuar një fond, presim fonde të tjera nga M.M, për ta mbyllur gjithë paketën e Mbrojtes Civile, jo vetëm për familje nevojë, jo vetëm për ato që ju ndodh një fatkeqësi, por edhe për investime të tjera që kanë të bëjnë me godina me tressik shembje apo blerje pajisje që përmirësojnë punën tonë të Mbrojtes Civile. Realizimi i të ardhurave është vendi ku duhet të punojmë më shumë për të aritur maksimumin e mundshëm të vjeles së të ardhurave për të patur sa më shumë shërbimi ndaj qytetarve, transferta e pakushtëzuar kap një vlerë 423 milion e 431 mijë lekë, ose 17.8% më shumë se vitin 2023, kemi një rritje prej 63 milion lekë, kjo efekt dhe në rritjen e çmimeve dhe pagave etj. Transferta e pakushtëzuar sektoriale kap një vlerë 186 milion 092 mijë lekë me rritje 13.058, kjo transfertë është për ato sektore që ne i mbulojmë, në total buxheti i bashkisë kap një vlerë 910 milion 097.301 lekë, të ardhurat janë pothuaj se në një nivel me një rritje të vogël 300.524 lekë dhe në tabelën përkatse keni detajimin sipas zërave ashtu si e citoava më parë. Ajo që ka ndryshe ky buxhet nga vitet e tjera, ka të bëjë mardhënia që kemi me Këshillin e Qarkut, ne sapo kemi miratuar buxhetin e Këshillit të Qarkut Korçë, nuk do ketë një transfertë direkte për ta kaluar në Këshillin e Qarkut, vlera prej 300.000 lekë që kishim parashikuar do e heqim edhe pse ju e kemi bashkë financime në nivele 60% me 40 % apo 70 me 30 në vartësi të investimeve që ne do planifikojmë, kjo është shumë pozitive, ne kemi parashikuar disa investime, shpenzimet opretteve kapin një vlerë 177.746 lekë, kemi transferimi koherente të brendshme, fond social, për herë të parë në këtë buxhet ju propzojmë një fond për nxënsit ekselentë, për të bërë nja pagesë për të gjithë vitin buxhetor në bashkpunim me zyrën Arsimore Vendore do kërkojmë listat përkatse dhe ne jemi të gatshëm ti paguajmë për një periudhë 9 mujore, kemi fond kontegjencë 21 milion lekë, i cili do përdoret me VKB për pagat. Transfertat janë të gjitha efektive, përvèç asaj të K.Qarkut që do e heqim, kemi parashikuar një fond për Drejtoren e Tatimeve për mardhënie ligjore 50.000 lekë, Klubi i Futbollit Maliq 9 milion lekë, Kombinati i Sheqerit Maliq 1.6 milion lekë për pagesë të mbartuara, fondi Social 1 milion lekë, fondi për Emergjecat Civile 6.559 mijë lekë, në total transfertat kapin një vlerë 39 milion 966 mijë lekë. Në lidhje me projketet kemi parashikuar një fond për projketim në nivelin 7.100.000 lekë, nëdrtim konstruktione 14.140 mijë lekë, rrugë 63 milion lekë, ujësjella kanalizime 10 milion lekë, pajisje teknike dhe instalime elektrike 6.741 mijë lekë, inventar ekonomik 529 mijë lekë, mbikqyrje dhe kolaudim 2 milion lekë. Komisioni i Ekonomisë në takimin që ne zhvilluam, propzoj blerjen e një mjeti vetëshkarkues me kapacitet të madh të jetë mbi 18 ton, do na shërbejë shumë për efekt të rrugve të parcelave, ndaj ne mendojmë të bëjmë një ndryshim ose te ky buxhet ose te ai shtesë pasi të rrakordojmë me drejtoren e Financës për të parë fondet që ne kemi kursyer nga Ujtje-Kullim dhe të bëjmë një miksim të të dy fondevë për të parashikuar një fond prej 5 milion lekë për blerje mejti mbi 18 ton. Investimet me afat 3-vjeçar kemi parashikuar dy projekte rikonstruksion objekteve në vlerë 25 milion lekë, të ndara ndër vite 2024, 2025, 2026 si dhe sitemmim-asfaltim rrugë viti 2024 vlerë 75 milion lekë e cila është e ndarë në %. Buxheti në total nga 831 milion 031 mijë lekë, shkon në 910 milion 098 mijë lekë, të ndarë sipas zërave, pagat, sigurime shoqërore kapin një vlerë 49.6%, shpenzimet operative 19.4%, invesimet



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

27% të buxhetit i cili mbulon edhe detyrime të prapambetura, të cilat duhet ti shlyejmë pastaj të bëjmë investime shtesë. Kuotën e Qarkut do e çojmë për blerje mjeti, të gjithë zërat e tjerë i keni. Keni limitin e shpenzimit të karburanit për çdo mjet, kemi bërë disa rregullime në vartësi dhe të performance-s që kanë patur, jemi mundur të jemi sa më minimalistë duke filluar nga mjeti i titullarit dhe kështu me radhë, janë të gjitha transparente. Detyrime për shoqërinë e mbetjeve KRMW 14 milion lekë, kontribut për Shoqatën e Autonomisë Vendore 640 mijë lekë, shpenzime për sipërmarjen e pastrimit ashtu si është miratuar nga Këshilli 47 milion lekë, miërbajtje program Tatim-Taksa-Financë 2 milion lekë, shpenzime për Këshillin, Këshilltarë paguhen 10% të pagës të Kryetarit të Bashkisë, pagesë Kryetarë fshati në nivelin 10% të pagës të Kryetarit të Bashkisë apo Administratoreve, në total shpenzimet për Këshillin shkojnë 13 milion lekë, 2 milion lekë trajnime, fond për karburant për Këshilltarët, fond dieta, bojë printeri etj. Shpezime për Mbrojtjen Civile janë 6 milion 559 mijë lekë, po për efekt të Emergjencës Civile dhe prezantimit të projektit në Ministri dhe te Prefekti ne parshikojmë një fond prej 10 milion lekë për pastrimin e kanalve kulluese dhe një fond prej 5 mijë e 5 qindëmijë lekë. Buxhetin e keni të ndarë sipas zërave, keni pasqyrat përkatse, keni një tabelë përbledhese të shpenzimeve për vitin 2024. Nëse ka pyetje? Në lidhje me investimet keni një pikë, ku këshilli i miraton në bazë programi, pastaj Kryetari i Bashkisë i detajon programt sipas problematikave. Zyrës të BE në bashki po i japim një peshë më madhe për të thithur donacione nga fondet e BE, kemi shtuar një punojës te kjo zyrë. Kemi parashkuar një fond prej 7.1 milion për hartim projekteve dhe një fond 6.3 milion lekë bashkë financime me K. Qarkut, ku do realzojmë një projekt për ndërtimin e muzeut të Maliqit diku te Pylli i Fazanve, që do ketë elementë nga tharja e kënetës, Plafitet etj, për cilin ka filluar një punë me M. Kulturës, ku ata do financojnë 60% të vlerës dhe ne 40%, do bëjmë dhe një projeket tjetër për në Maliq për pjesën e vilave të ndëruara në vitet 48-52, do e sjellim në kohë këtë projekt, do realzojmë dhe rikonstrukcionin e shkollës të mesme Maliq dhe ndërtimin e një Palestre, është e vetmja shkollë në qendër që nuk i përbush ato kapacitete që kërkohen. Ndërtime dhe konstruksione, kemi një fond prej 25 milion lekë për ndërtimin e çative të pallateve në Drithas, për ti paraprirë një fondi të FSHZH për sistemin kapot, do shikohen dhe godina në Maliq, Libonik dhe Veltérne. Kemi parashkuar fond për bashkë financim projekte 2 milion lekë pjesën ndërtime konstruktion edhe 5 milion lekë në rrugë, 300 mijë lekë që do i heqim nga Këshilli i Qarkut, këto fonde dhe ato që do na teprojnë nga Ujite-Kullim do blemë një mjet vetë-shkarkues 5 milion lekë, për të cilin do sygjeroja ta futim në buxhet si një domozdoshmëri shumë e madhe, në lidhje me ndërtime dhe konstruksione do zbatojmë një projekt, terren sportiv Drithas poshtë, fusha e sportit do i shërbeje dhe ekipit të Maliqit por dhe shkollave, do bëjmë investim për rrëthim, dhoma zhveshje, vaditje etj do synojmë dhe ndriçim. Kemi pagesë për Kopshtin e Maliqit për EKBN 1140 lekë. Në lidhje me rrugët kemi një fond prej 40 milion lekë, për shtresëne dytë të tapetit kudo ku kemi asfaltuar, kemi asfaltuar rrëth 15 km rrugë në çdo NJ.A të fushës, por i kemi me një shtresë, kemi një fond prej 75 milion lekë për rrugë të reja, kemi parashkuar një fond prej 3 milion lekë, për betonim kthesa të vështira në zonën e Gorës dhe Moglicës, kemi parashkuar një fond prej 10 milion lekë, për Ujësjellës-Kanalizme nuk e kemi preçizuar akoma, por kemi disa Ujësjellsa, ku bashkë me Ujësjellësin e Korçës sh.a i kemi futur në



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ

prioritetet tona, dua të citoj Ujësjellësin e Zvezdës që e kemi prioritetet dhe rrjeti i brendshëm i Gorës dhe Moglicës ku ka probleme, në material keni gjithë Ujësjellsat që kemi prioritetet, Podgorie dhe ai i Pirgut, kemi parshikuar një fond prej 4 milion lekë për blerje ndriçuesash, kemi hasur probleme me cilësinë e ndriçuesash, kemi parshikuar një fond për blerje pompa për shkolla, kemi parshikuar një fond për blerje Instrumenta muzikorë dhe blerje forni për Pallatin e Kulturës dhe blerje kamara për shkollat e mesme, fond për blerje kompjutresh për shkolla, buxheti shtesë do ketë një përmirësim të dukshëm në fonde të dedikura për arsimin, pasi janë fonde që kursehen, nga fondet e pagave. Kjo ishte besoj tabelë më e rëndësishme, bashkangjitur me të keni dhe tabelën përbledhse të detajimit të fondeve, bashkangjitur P-V keni tabelën e investimeve prioritare, jemi muduar ta shtirjmë në të gjithë programet buxhetore, në Kulturë projekti më ambicioz është përmbyllja e ish Pallatit të Kulturës "Dhimitër Orgocka", kemi zbatuar fazën I, tani jemi për ta përmbyllur me FSHZH, pasi nuk kemi mundësi ta zhvillojmë vetë, ndërtimi i Muzeut të Plafiteve, rebilitimi i fushave sportive, Zvirinë, Vreshtas dhe Drithas, në rrugë, kemi futur sistemim-asfaltim NJ.A me vlerë 250.000 lekë që e prizontojmë te FSHZH, një shëtirore Dritha-Ura e Dunavecit, kjo shëtitore nuk do i shërbejë vetëm komunitetit, por do lidhet me Pyllin e Fazanve, FSHZH do ndërhyjë nga Pylli i Fazanve në drejtë Urës të Dunavecit, po punojmë me ARSH për këtë segment që ta financojë, kemi bërë kërkesë pranë FSHZH për materialet bazë, ne do mbulojmë suqjnë punëtore, sistemim urban në qytetin e Maliqit, po punojmë me dy projekte të mëdha për Pojanin dhe Podgorien për ti kthyer në zona Urbane dhe dy Pole, sistemim-asfaltim rruga Maliq -Kolanec është prioriteti jonë dhe, sistemim-asfaltim rruga e Strelcës, janë dy zona që ne duhet ti shikojmë si zona turistike dhe po ndërhyjmë pjesë-pjesë, ndaj edhe me K.Qarkut po shikojmë ashtu si po mbyllim rrugën nga Pogradeci në Kakaç-Shqitas dhe këtu kështu do operojmë. Ujësjella-Kanalizme i citova Zvezda-Podgoria, Pirgu, rrjeti i brendshëm i Sheqerasit, Vreshtasit, rrjeti i brendshëm i Gorës dhe Moglicës janë prioritetet tona, kemi aplikuar pranë FSHZH për tubacione të ujrate të bardhe e të zeza, kemi marrë një pjesë dhe shumë shpejt fillojmë në ujrate zeza në një zonë në Klocë, Vloçisht dhe Veliternë, kët synojmë dhe me ujësjellsat. Në arsim, një kopësht në Libonik, Sheqeras, ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Zvirinë, palestër në Maliq, po mundohemi të bëjmë një projekt me ngrohje qëndrore të të gjithë shkollave të bashkisë, ndërtim palestre shkolla Prig, ndërtim shkolla cikli i ulët F.Maliq. Ujitje-Kullim janë tre projekte, reabilitim kanal-kullues fshati Vashtëmi, betonim kanal-ujitës rezevuari i Podgories, pastrim-betonim kanal-ujitës Podgorie-Sovjan, ka bllokime te ai kanal. Objekte ndërtimore sistemi kapot Drithas dhe Maliq, reabilitim Qendra-Komunitare Vloçisht, Vreshtas, Zëmlak dhe Tërovë. Një P-V tjetër ju mund ti merrni një nga një se unë i kapa të gjithë, Honoraret e Artisteve Amatorë, me K.Qarkut po synojmë të kemi një festival Folklorik të gjithë Qarkut, duam të tërheqim gjithë artsitër amotorë nga gjithë NJ.A e bashkisë, ndaj kemi parshikuar dhe këtë fond, për mbulimin e shpenzimeve. Për herë të parë sjellim një P-V për valltarët, Sektori i Kulturës të fillojë të përzgjedhë elementë nga çdo shkollë dhe kushdo që mund të ketë të dhëna për valltarë dhe ne ti paguajmë 4000 lekë në muaj përfshirë asaj çka e kanë të domzdoshtme, praktikë që ndiqet dhe nga bashki të tjera ne po e vemë zbatim për herë të parë dhe shpresojmë të jetë rezultativ. P-V përmiratimin e bursave të ekselencës si vit i parë ne i japim 2500 lekë në muaj, pastaj dhe të



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

shohim vitin që vjen numri të jetë më i madh dhe si nxënës dhe shpërbilmi.Këto kisha Kryetar.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit Z.Kreytar! Jemi te buxheti, kryetari shpejgoj dhe tre materiale të tjera.Jemi te buxheti, kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim buxhetin?

**Aleksandra Spaho:**Kisha diçka, te fondi Social dhe Mbrojtje Civile më duket shumë i ulët!

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Për Mbrojtjen Civile jemi në të njëjat nivele si një vit më parë, me pak rritje, por duke marrë dhe fondin tjetër që M.Mbrojtjes e çel brenda muajit Janar-Shkurt, ky fond nga 6.5 milon, shkon në 15 milon lekë, ky fond është i dedikuar ku përdoret, raste zjarri dhe nuk kemi detyrime, vetëm disa të vogla përfshin Pendavinj të cilat mbyllen këtë vit, një pjesë të fondeve i kemi futur në blerje pajisje apo mjete që me VKM lejohen për raste emergjente apo godina në raste shemebje, ashtu si kemi vepruar përfshin Pallate, ndërsa përfshin Social mund të kemi një shtesë, besoj se te buxheti shtesë do e shohim përfshin plotësuar.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit! E kalojmë në votim buxhetin?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit!Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V“Për miratimin e listës të investimeve prioritare të Bashkisë Maliq përfshin vitin 2024”; Ka ndonjë pyetje?

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Jam munduar të përfshiri të gjitha prioritetet që kanë jo vetëm Këshilltarët por edhe komuniteti, kjo është një listë prioritare, nuk është listë e investimeve që ne realizojmë, por listë e prioritetave që e çojmë në institucione të ndryshme, FSHZH, Ministritë etj, përfshin nga kriteret që kanë vendimarrjen e Këshillit.Nëse dikush ka një investim që do ta shtojë, po që ka efekte, ne jemi të gatshëm ta shtojmë.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Te pika 6 kemi diçka? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimitar 2024-2026”;

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Ky është një detyrim ligjor përfshin buxhetin e vitit 2024, i shtojmë tavanet buxhetore dhe ja u prezantojmë si detyrim ligjor, përfshin prezantuar në M.Financave dhe ata pasi njihen me materialin bëjnë vëretjet e duhura e sjellim përsëri në mbledhje Këshilli, kjo nuk është fakt që ne do e realizojmë, por është buxheti aktual plus Tavanet Buxhetore përfshin strukturë të miratuar me VKM.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Kemi diçka? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”;

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Edhe kalendar buxhetor, janë hapat që ne ndjekim, që nga nxjerja e hurdhrit për të filluar këtë proces, dëgjesat me publikun, miratim në Këshill dhe deri Projekt-Buxhetin dhe pastaj Buxheti në fund të vitit.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Kemi diçka? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e shpërblimeve honorare për artistët amatorë”;

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Atë që do sygjeroja unë të ketë sa më shumë artistë të bëhen pjesë e këtyre aktivitetave dhe ju mund ti dini në zonat tuaja që janë artistë amatorë të ndryshëm.Nuk ka listë të caktuar, ka specialisëtë të fushave të ndryshme që marrin në konkurs.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit!Kemi diçka tjeter? kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pika 10 e rendit të ditës, P-V “Për miratim bursa për nxënësit ekselentë”;

**Ornildi Demollari:** E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Suksese nxënsve. Kalojmë te pika 11 e rendit të ditës, P-V “Për shpërbilm valltarësh” Ajo çka folëm më parë.

**Ornildi Demollari:** E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pika 12 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e raportit të likujdimit të shoqërisë “Klubi i Futbollit Maliq” sh.a.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Ky është një raport që nuk del me disiçit dhe nga sh.a ne e kaluam në Shoqatë, të zbatojmë njëakt ligjor të detyrueshëm dhe kursejmë lekë për pagesat e Këshillave Mbikqyrës, shpresojmë që Klubi i Futbollit të ketë sa më shumë rezultate të mira etje ku luan.

**Ornildi Demollari:** E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pika 13 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit përmuajin nëntor 2023”;



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**Aleksandra Spaho:** Personalisht nuk merrem se kush përsiton ndihmë ekonomike, kemi një problem serioz se shumë familje janë larguar nga skema, për shkak se një pjestar i familjes është largaur si emigrant, por familja ka edhe pjestarë të tjerë në familje që i duhet ndihma ekonomike dhe problemi tjetër që kemi, që familja për një muaj penalizohet gjashtë muaj, të gjemjë një rrugë ta zgjidhim këtë problem, ti drejtohami Ministrisë, për familjet që janë vërtet në nevojë.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit!

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:** Shqetësimi është me vend, por nga kuadri ligjor nuk kam mundësi, unë do isha shumë dakord që Këshilli i bashkisë mund ti drejtohet Ministrisë të Mirëqënies Sociale duke e ngritur si shqetësim, ndoshta ata mund të marrin një nisëm ligjore për ta rregulluar këtë moment, mbështetje duhet të kishte kriterë specifike. Drejtoria e Shërbimit Social të na sjellë një propozim, që ne me fondet tona mund të trajtojmë 10 familje që mund të jenë në kushte të vështira ekonomike.

**Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:Ermando Petriti:** Kjo është në VKM, një nga kriteret që familjet që largohen në emigracion nuk mund të përfitojnë ndihmë ekonomike. Mund të përdorim dhe fondin 3% si vitin e kaluar për disa familje që janë penalizuar nga sistemi i ndihmës ekonomike për asrsye të ndryshme dhe familja është vërtet në kushte ekstreme mund ta përdorim dhe këtë vitin 2024, duke patur dhe një fond social në buxhet.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:** Fondin mund ta ritim dhe në buxhetin shtesë, por këtu duhet të jemi shumë korekt në përzgjedhjen e familjeve.

**Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:Ermando Petriti:** Në fillim të vitit ne përcaktojmë kriteret për familjet e fondit 6% dhe 3%, atje të jemi specifikë me kriteret që duhet të plotësojë një familje për të përsituar këtë masë.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit! Kalojmë te pika 14 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e bursave të arsimit së mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të mesëm profesional të vitit shkollor 2023-2024”;

**Pranvera Begolli:** Ta kalojmë për miratim P-V.

**Ornildi Demollari:** Kemi diçka ? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit!Miratohen dy P-V të veçantë.

**Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:Ermando Petriti:** Për arsimin profesional kemi kuota të lira dhe kërkesat që kemi patur patjetër që do i shtojmë në listë.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**Ornildi Demollari:**Jemi te pika 15, Diskutime të ndryshme.Kemi diçka këtu, Andonaqi kishte diçka për një zonjë nga fshati Tërovë, që është në kushte të vështira ekonomike dhe vuani nga një sëmundje dhe ka nevojë për supror financiar.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Kemi dy raste në fshatin Tërovë dhe Sovjan, ku një famije ka mbetur jashtë, duhet një mbështetje me vlerë 60.000 lekë dhe për rastin e fshatit Tërovë një ndihmë me vlerë 50.000 lekë do ishte e domozdoshme për atë problem që ka zonja.Për këto dy raste do kërkoja mirkuptimin e Drejtorisë së Financës për të gjetur fondet, përti ndihmuar këto dy familje në këtë fund vit.

**Ornildi Demollari:**P-V Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë, famija e z.F.D fshati Sovjan dhe Znj nga fshati Tërovë V.C, Zotëria nga Sovjan i akordohet shuma 60.000 lekë dhe Znj nga Tërova 50.000 lekë.

E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit!

**Floreta Zaçe:**Kam edhe unë diçka, kemi një familje në Poajn që ka patur një rast vdekje, familja është shumë e varfër, kanë dhe probleme shëndetësore, pas ndarjes ngajeta të nënës ata kanë shumë probleme, ta ndihmojmë me diçka.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Të sjellin një kërkesë zyrës të Shërbimit Social dhe të shohim si mund ti ndihmojmë.

**Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:Ermando Petriti:**Patjetër që mund ta ndihmojmë mennjëherë me fondin që kemi nga projekti.

**Ornildi Demollari:**Dhe njëherë jemi dakord për këto dy familje?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro.Faleminderit!Diçka tjetër te kjo pike?

**Aleksandra Spaho:**Na kanë ngelur disa Kryetarë fshati pa zgjedhur, fshati Zvezdë dhe fshati Drithas poshtë, unë dhe si anëtarë Këshilli dhe si personi që kam qenë në Zvezdë por dhe si përsaqësuese e PD, kam dy fjalë, në lidhje me fshatin Zvezdë ka ndodhura ajo çka kemi thënë ku njëra palë pretendon ndryshe, propzoimi im është konkret, të bëhet dëgjesë publike në fshat si do zgjidhet Kryetari i fshatit, ose me lagje ose në bazë fshati, të caktojmë një datë, ta vendosi fshati si duhet, për Drithas poshtë, kemi marrë vendim që do ndajmë si fshat, nëse ne nuk na lejohet ta ndajmë si fshat ti përsëritim dhe njëherë zgjedhet bashkë me Drithas lart dhe të jetë vetëm një kryetar.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Duke qenë në fund të vitit ta mbyllim me fjalë të mira, por ky është një moment që Këshilli duhet ti japë një zgjidhje. Atje ka Këshilltarë nga Pojani dhe Zvezda, mund të sjellin ata një informacion çka ndodhur në Zvezdë? Për fshatin Drithas kemi vendosur që Këshilli ti trejtohet Institucionit të Prefektit për një zgjidhje. Nëse Këshilla ka të drejtë të ngrejë një strukturë në Drithas poshtë, sepse është një fshat i madh, që të gjenden modatilitetet kush ka të drejtë, të konkurojë sipas subjeteve, sipas listës të votimit.

**Andonaq Risto:** Si Këshilltar i NJ.A Pojan kam ndjekur procesin në Zvezdë, njëri nga kandidatatët ka dhënë dorëheqje dhe mbetet automatikisht tjeteri, ishte i rregullt, u votua në çdo shtëpi, kemi mbajtur proceverbal dhe e kemi dorzuar te Sekretari i Këshillit. Kanë firmosur Këshilltarët e fshatit.

**Rudina Bregu:** Ne si grup e kemi përgatitur raportin, që u la si detyrë në mbledhjen e datës 18.12.2023. Po ja u lexoj raportin.(bashkangjitur).

**Aleksandra Spaho:** Unë po flas në emër të PDSH dhe tu sillja një propzimi në emër, të partisë dhe të bëhen zgjedhjet nga e para.

**Rudina Bregu:** Për parqitjen e kandidaturave ka një afat.

**Ornildi Demollari:** Faleminderit! Kjo ishte mbledhja për sot.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:** Ju uroj Gëzuar vitin e Ri 2024!

**Mbajtës Protokollit**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Gertjan GJIRITI**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**

